

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 27.07.2024*

**27.07.2024
Ora 11:30**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- Stafii KQZ: Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, znj. J. Josifi.
Parti Politike: S’ka prezent!
Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjesi, në seancë kemi në rend dite projektvendimin “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”. Po Pavlina, shkurt!

Znj. P. Doçaj: Me vendimin nr. 4, dt. 24.07.2024, Kolegji Zgjedhor ka miratuar karakteristikat e fletës së votimit, karakteristika teknike për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 133, datë 26.07.2024 miratoi rezultatin e shortit për përcaktimin e renditjes së kandidatëve për kryetar në Bashkinë Himarë, në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të kësaj bashkie. Nisur nga sa më sipër paraqesim për shqyrtim projektvendimin “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 27.07.2024*

kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”. Bashkëlidhur edhe “lidhja nr. 1”, ku është fleta e votimit.

Z. I. Celibashi: Dakord! Këtë fletë votimi, këtë përmbajtje ua kemi nisur dhe partive politike? Ua kemi konsultuar dhe kemi dakordësinë e tyre! Në rregull! Një korigjim te emri i babait të kandidatit të renditur i dyti, për pjesën tjetër jemi dakord. Mirë, atëhere:

- Miratojmë përmbajtjen e fletës së votimit sipas modelit të propozuar dhe ndërkohë t’ia përcjellim menjëherë dy kandidatëve për çështje të fushatës së tyre.

Mirë faleminderit, çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi, seanca mbyllet! Ditë të mbarë!

Vendimi nr. 144

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

